

STATUT
PER KRIJIMIN SI PESON JURIDIK TE SHOQËRISË

“Green Century .Albania “
:
(Shoqëri me Përgjegjësi te Kufizuar)

Në bazë të ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe, ligjit nr.9723. date 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit te biznesit ” me ndryshimet e reja ne vazhdim, ne te nënshkruarit:

1- Lulzim Kashnica, atesia Dhimiter, amesia Denisa, lindur me date 13.02.1991, lindur ne Fier, banues ne Fier, madhor, me zotesi te plote juridike per te v epruar, i pajisur me pasaport e personale per identifikim BB 3897032.

2-Shpetim Krashnica, atesia Nuri, amesia Kimete, lindur me date 25.03.1964, banues ne Kanada, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i pajisur me pasaporte personale te leshuar nga Institucioni perkates ne Kanada numer GK 824024.

FORMIMI I SHOQËRISË
Neni 1

Formohet shoqëria e quajtur **“Green Century .Albania “ “SH.P.K.** (Qe këtu e me poshtë referuar si “Shoqëria”, e cila themelohet nga **ortaket e sipercituar**, si me poshtë:


QENDRA E SHOQËRISË
Neni 2

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën:Rruga”Lagja “Liri 3, bulevardi :Jakov Xoxa”, pallati Bajraktari, shk.2, ap 6, Fier-Shqiperi.

Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale, zyra përfaqësimi, ne te gjithë vendin gjate aktivitetit te saj, brenda ose jashtë territorit te vendit.

KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE
Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është me nje afat kohor
” TE PA KAKTUAR ”



OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është si më poshtë:

Ushtrim veprimtarie Fast Food, prodhim produktesh per agroturizim, bare , restorante, hoteleri-Turizem.

Eksport-Import, shitje dhe blerje te produkteve te agroturizmit , te bareve, hotelerive,,...etj,

Ushtrim veprimtarie ne Hoteleri-Turizim, Restoranteve , Bar-Kafe, Agjensi udhetimi, agjensi detaree ajrore.

Import eksport , shitje dhe blerje, te mallrave te ndryshme te mobilerive, te mallrave te ndryshme ushqimore , te lendeve te ndertimit,lendeve te drurit , lendeve elektrike dhe hidraulike,etj.

Veprimtari ne fushen e ndertimit, te ndertimit te rrugeve, banesave, qendrave te biznesitetj.

Veprimtari ne shitje dhe blerje, import eksport t e mallrave motorrike, automjete...etj.

Neni 5

Kjo shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të rrisë kapitalin sipas vendimeve të Ortakeve te Vetëm dhe sipas parashikimeve te ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 6

Kapitali fillestar i shoqërisë është 100.000 leke, i ndare ne dy kuota.


Zoti. **Lulzim Kashnica**, zoteron kuota kapitali 35% dhe zoteron 1(nje) kuote.

Zoti. **Shpetim Krashnica**, zoteron kuota kapitali 65%, dhe zoteron 1(nje) kuotë.

Kapitali zotërohet 100% nga ortakët e vetëm te shoqërisë.

Ortakët e vetëm mund te vendosin te rrisin kapitalin e shoqërisë ne përputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe me vendim te ortakeve te vetëm. Detyrimet e ortakeve kundrejt shoqërisë do te mbulohen vetëm me pjesën e kapitalit te paguar prej tyre. Ortakët nuk do te ketë asnjë përgjegjësi tjetër për detyrime te tjera te shoqërisë.

Neni 7



Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të zvogëlohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit të Asamblesë së Ortakeve të Vetëm të Shoqërisë.

REGJISTRIMI I SHOQERISE

Neni 8

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky Statut si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar në datën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të bizneseve (QKB) sipas nenit 43 të ligjit 9723 date 3.5.2007.

Neni 9

KALIMI I KUOTAVE

Pjesët shoqërore të ortakut të vetëm përputhen me pjesën e tij në kapitalin e shoqërisë.

Kuotat e kapitalit të shoqërisë si dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen nëpërmjet :

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes së kuotave
- c) trashëgimisë
- d) dhurimit
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar në ligj.

Pjesët e tij çdo ortak i shoqërisë mund t'ua ofrojë të tretëve, të cilët nuk janë anëtarë në shoqëri. Në rast se shoqëria do të ketë në të ardhmen me shume se një ortak, në këtë rast ortakut i cili ka vendosur të transferojë apo shesë kuotat e tij, duhet të drejtojë një kërkesë me shkrim Organit Administrativ duke saktësuar çmimin e shitjes, i cili duhet të jetë i arsyeshëm dhe të jetë i njëjtë me atë që do t'i ofrohet dhe një personi të tretë jashtë shoqërisë si dhe të dhënat e blerësit.

E drejta e përparësisë për nënshkrimin e kapitalit është në proporcion me kuotat e secilit prej ortakëve.

Personi që kalon kuotën dhe ai që fiton atë përgjigjen në mënyre solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës nga çasti i kalimit të kuotave deri në çastin e regjistrimit të kalimit .

Shoqëria regjistrohet kalimin e kuotave sipas nenit 43 të ligjit 9723 .



Neni 10


Emërtime të shoqërisë tregtare, kapitali themeltar, emri i administratorit , duhet të jete të përmendura në të gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqëri dhe që ju drejtohen të tretëve. Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme dhe me përmbajtjen përreth saj.

Neni 11

Shoqëria vepron nën regjimin e pronës private dhe merr përsipër vete të drejtat dhe detyrimet kontraktore

Organet e shoqërisë janë:



- 
- 1- Asambleja e Ortakeve te Vetëm te Shoqërisë
 - 2- Administratori i shoqërisë.

KOMPETENCAT E ORTAKUT TE VETEM

Neni 12

Për mënyrën e drejtimit dhe ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë, Ortaket e vetëm Vetëm shprehet me vendime për gjithçka që është në kompetencat e tyre të përshkruara si më poshtë:

Neni 13

Marrja e vendimeve të Ortakeve të Vetëm regjistrohen në regjistrin e vendimeve të ortakeve të vetëm, mbajtja e procesverbaleve dhe të gjitha dokumentet e tjera që kanë të bëjnë me të duhet të behën sipas legjislacionit në fuqi për këtë qellim.

Neni 14

THIRRJA E ASAMBLESE

Asambleja e përgjithshme thirret sa here që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Neni 15

PJESEMARRJA NE VENDIME

Çdo ortak, ne rastet kur shoqëria do të ketë me shume se një ortak, ka të drejtë të marre pjesë në vendime si dhe disponon një numër votash barabartë me pjesët e kapitalit themeltar që ai zotëron.

Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marre vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortaket me të drejtë vote, që zotërojnë me shume se 30% të kuotave. Në rastin kur asambleja duhet të vendosë për çështje që kërkojnë shumicë të kualifikuar si për shembull ndryshime në statut, zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të regjistruar, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe shpërndarja e shoqërisë ajo mund të marre vendime të vlefshme kur vendos me tre të katërtat e votave të ortakeve pjesëmarrës personalisht, ose që votojnë me shkresë po me mjete elektronike.

ADMINISTRIMI

Neni 16

Shoqëria administrohet nga një administrator i cili caktohet në statutin e shoqërisë dhe me pas nga Vendimet e Ortakeve të vetëm apo nga Asambleja e Ortakeve në rast se shoqëria do të ketë me shume ortak. Administratori qëndron në detyrë për një periudhë **kohore 5 (pese) vjeçare**, më të drejtë riemërimi nëpërmjet vendimit të Ortakeve të Vetëm të Shoqërisë. Në rast se gjatë kësaj periudhe shfaqen probleme paaftësie nga ana e secilit ortak, Ortaket vendosin shkarkimin e tij. Në asnjë rast ortaket nuk i duhet të justifikojnë apo provojnë se cilat janë shkaqet për të cilat shkarkon administratorin. Në çdo rast janë ortaket të cilët vleresojnë se shkaqet e arsyeshme për shkarkimin e administratorit.



Administratori detyrohet te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarisë tregtarë te shoqërisë duke zbatuar politikat tregtarë te vendosura nga asambleja e përgjithshme.

Ai kujdeset për mbajtjen sakte dhe te rregullt te dokumenteve, dhe te librave kontabël te shoqërisë.

Ai përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor te shoqërisë, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë se veprimtarisë, dhe se bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve ja paraqet këto dokumente asamblesë se përgjithshëm te ortakeve për miratim.

Ai ka te gjitha kompetencat për te vepruar me tretet ne emër te shoqërisë dhe ne interes te saj ne te gjitha rrethanat me përjashtim te kompetencave qe ligji dhe Statuti i shoqërisë ja jep shprehimisht Ortakeve te Vetëm.

Administratori emërohet me një afat kohor 5(pese) vjeçar.

Administratorit nuk i lejohej te kontraktoje me te tretet ne çfarëdo lloj forme qofte, nuk i lejohej te marri hua tek shoqëria, te japi pëlqimin për çështje te ndryshme ne emër te saj, nuk i lejohej te japë paradhënie, te behet dorëzanes apo te garantoje ne emër te shoqërisë apo te ortakeve te vetëm etj., përveç rasteve kur ai ka marre një miratim përkatës me shkrim nga ortaket.

Administratori ka te drejte te kryeje vetëm ato veprime te cilat kane te bëjnë me administrimin e përditshëm dhe te zakonshëm te shoqërisë.

Administratori mund te japi prokura tek te tretet brenda kufijve qe ligji e lejon dhe ne kufijtë qe i lejojne Ortaket e vetëm apo Asambleja e Ortakeve për kategori te caktuara veprimesh.

Te gjitha veprimet e tjera duke përfshirë pagesa, detyrime për tu paguar, veprime me institucionet bankare ku përfshihen transfertat bankare tërheqje parash etj., do te kryhen nga administratori vetëm pasi te jete dhëne miratimi me shkrim nga ortaket e shoqërisë.

Administratori i shoqërisë është caktuar Lulzim Kashnica, atesia Dhimiter, amesia Denisa, lindur me date 13.02.1991, lindur ne Fier, banues ne Fier, madhor, me zotesi te plote juridike per te v epruar, i pajisur me pasaport e personale per identifikim BB 3897032.

MARRREDHENIET E PUNES

Neni 17

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës se punës dhe legjislacionit te punës ne fuqi. shoqëria merr përsipër te respektojë rregullat ne fuqi te punësimit dhe te punësuarit janë te detyruar qe te respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punësuarit duhet te përgjigjen për demet qe i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT

Neni 18

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohej te behet publike përmbajtja e tyre për te tretet e te gjitha akteve dhe dokumenteve qe janë përcaktuar si te tilla nga



administratori i shoqërisë.

EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL

Neni 19

Kontrolli mbi veprimtarinë e shoqërisë si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet një ekspertit ose revizori kontabël. Ky ekspert do të emërohet dhe qëndroje në detyrë sipas parashikimeve të ligjit përkatës. Ortaku cakton dhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma të veçanta ligjore.

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 20

Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit. Administratori merr masat me qëllim hartimin e bilanceve, rezultateve ekonomike të fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit të çështjeve të mësipërme si dhe shlyerjen e detyrimeve, të ardhurat e tjera do të kalojnë ortakut të shoqërisë.

Neni 21

SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Ne rast se shoqëria shpërndahe për çdo lloj arsye Ortaku i vetëm përcakton mënyrën e likuidimit, emëron një ose më tepër likuidator dhe përgatit të gjitha dokumentet e nevojshme për c 'regjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit të biznesit QKB.

LIBRAT E SHOQERISE

Neni 22

Po kështu shoqëria në bazë të ligjit mban librat e mëposhtëm:

- 1) Libri i Ortakut të Vetëm.
- 2) Libri i vendimeve të organit administrativ.
- 3) Libri i mbledhjeve dhe vendimeve të eksperteve ose revizoreve kontabël.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 23

Përsa është shprehur në këtë statut i referohemi ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", dhe ligjit nr.9723. datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Çdo ndryshim behet në përputhje me këtë Statut dhe nuk prek personalitetin juridik të kësaj shoqërie.


Statuti është hartuar në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe .

Data.30.05.2023



ORTAKET E VETEM TE SHOQERISE "
"Green Century .Albania "

- Lulzim Kashnica **LULZIM KASHNICA** 

- Shpetim Krashnica **SHPETIM KRASHNICA** 





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER SHPRESA GJOCI
ADRESA NJESIA AMDINISTRATIVE
NR. 5,
TEL: 0682071706

VËRTETIM NËNSHKRIMI NË AKTE TË NDRYSHME OSE NË DEKLARATA PERSONALE

Nr. repertori: 5547

Tirane më 30/05/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



V2023053920193596285

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER SHPRESA GJOCI



DATE 30/05/2023
NR REP 5547

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 30.05.2023(dy mijë e njetë e tre), para meje Notere SHPRESA GJOCI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane , u paraqit personalisht:

DEKLARUES/IT:

1- Lulzim Kashnica, atesia Dhimiter, amesia Denisa, lindur me date 13.02.1991, lindur ne Fier, banues ne Fier, madhor, me zotesi te plote juridike per te v epruar, i pajisur me pasaport e personale per identifikim BB 3897032.

2-Shpetim Krashnica, atesia Nuri, amesia Kimete, lindur me date 25.03.1964, banues ne Kanada, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i pajisur me pasaporte personale te leshuar nga Institucioni perkates ne Kanada numer GK 824024.

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "STATUT per krijimin si person juridik te shoqerise "Green Century Albania " SH.P.K.

Unë Noteri/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

SHPRESA GJOCI

